



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.603/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Asfalt Group” shpk, me nr. Biznesi 810082397, me seli ne Klinë-Gremnik, ndaj debitorit NNSH “Korben” shpk, me nr. Biznesi 811192726 me seli ne Gjakovë rr. “Nena Terezë”, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.331/22 dt.30.12.2023, me datën 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e debitorit NNSH “Korben” shpk, me nr. Biznesi 811192726 me seli ne Gjakovë rr. “Nena Terezë”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.331/22 dt.30.12.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.331/22 dt.30.12.2023, e ka hedhur poshtë si te palejuar ankesën e datës 19.06.2023 e paraqitur nga ana e debitorit NNSH “Korben” shpk, me nr. Biznesi 811192726 me seli ne Gjakovë rr. “Nena Terezë” e ushtruar kundër aktvendimit te Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles e Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike PPP.nr.331/22 dt.14.06.2023 për caktimin e garancionit.

Kundër këtij aktvendimi, debitori ka ushtruar ankesë, për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës administrative, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe te vendos ne mënyrë meritore lidhur me të.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Asfalt Group” shpk, me nr. Biznesi 810082397, me seli ne Klinë-Gremnik, me datën 07.12.2020, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit NNSH “Korben” shpk, me nr. Biznesi 811192726 me seli ne Gjakovë rr. “Nena Terezë”, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave nr.19-SHMK1-001-19, 19-SHV01-001-39. Përmbarruesi Privat Gjokë Radi-Gjakovë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.497/20 dt.07.12.2020, ka lejuar përmbarrimin ne bazë te dokumentit te besueshëm, përmes se cilit ka obliguar debitorin qe kreditorit ne emër te borxhit sipas faturave t'ia paguaj shumen prej 14,800.00 euro, me kamatëvonesë prej 8% vjetore si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër këtij urdhri me datën 18.12.2020, debitorin ka ushtruar prapësim, me pretendimin se nuk është bere pranimi teknik i punëve te kryera nga kreditorit ne këtë rast sepse punët janë kryer me kualitet jo te mire dhe jashtë çdo standardi, nuk mohon kontratën me kreditorin për kryejnë punëve asfaltimi i rrugëve Dol-Kuhsavec dhe Babj te Bokes, propozon qe gjykata ta aprovoj këtë kundërshtim/prapësim dhe te abrogohen te gjitha veprimet e ndërmarra.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit, me datën 22.12.2020 ka ushtruar kreditorin, me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë te pabazuara sepse pranimi teknik për projektin ne fjale është bere se debitorin nuk ka asnjë fakt i cili e konteston këtë, andaj propozon qe gjykata ta obligoj debitorin qe ne afat prej 7 ditësh ta përmbush obligimin.

Gjykata e shkalles se parë pas shqyrtimit te prapësimin, përgjigjes ne prapësim dhe shkresave tjera te lendes, ka nxjerr aktvendim KPPP.nr.331/22 dt.30.12.2023, me te cilin e ka hedhur poshtë ankesën e debitorit te ushtruar ndaj aktvendimit PPP.nr.331/22 te datës 14.06.2023 përmes se cilit është caktuar garancioni dhe obligimi debitorit për deponim te shumes se garancionit ne Këshillin Gjyqësor te Kosovës, me vërejtën se ne rast se nuk deponohet shuma e garancionit sipas këtij aktvendimi konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare. Gjykata ne aktvendimin e saj i referohet nenit 78 te LPP dhe nenit 387 par.2 dhe 435 te LPK. Po ashtu gjykata konform nenit 186 te LPK dhe nenit 78 te LPP vendos si ne dispozitiv te aktvendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë ne shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, as në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë përkitazi kësaj çështje vlerëson nenin 78 par.1 te LPP i cili thotë se “Gjykata e shkalles se parë, ne rastet kur debitorin dëshiron te parashtrorj ankesë kundër vendimit me te cilin është refuzuar prapësimi i tij ne lidhje me propozimin për përmbarrim ne bazë te dokumentit te besueshëm, urdhëron palën ankuese qe te paguaj garancinë ne te holla, si parakusht për

parashtrimin e ankesës, përveç nëse pagesa e garancisë i shkakton dëm te pariparueshëm palës ankuese dhe nëse dëmi është i ndryshëm ose nuk është i lidhur me humbjen që do të shkaktohej me rastin e pagesës së kredisë”, po ashtu par.4 i këtij neni, përcakton se “nëse pala ankuese dështon të paguaj shumën e garancisë të caktuar nga Gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese. Prandaj lidhur me këtë çështje kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës e shkalles së parë sepse debitori shiquar nga shkresat në lende del se nuk ka vepruar në pajtim me obligimin që del nga Vendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkalles së Parë KPPP.nr.331/22 dt.14.06.2023 përmes së cilit gjykata e ka urdhëruar debitorin që të deponoj shumën prej 14,800.00 euro në llogari të veçante të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe atë në afat prej tre (3) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, me vërejtjen se nëse debitori nuk e deponon garancionin brenda afatit prej 3 ditësh konsiderohet se ankesa nuk është dorëzuar fare.

Andaj, duke marr për bazë faktin se nga shkresat e lendes nuk rezulton se debitori ka deponuar shumën e garancionit ashtu siç e ka obliguar gjykata e shkalles së parë dhe se i njëjti nuk e ka provuar përmes ndonjë parashtrësë ose kërkesë me shkrim, faktin se pagesa e garancionit i shkaktohet dëm te pariparueshëm te njëjtit, atëherë kjo gjykatë në vlerësim të nenit 186 par.1 të LPK i cili parasheh që “Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë jo të plotë, apo të palejueshme e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore”, konsideron që ankesa e debitorit është e palejuar dhe si e tillë duhet të hedhet poshtë.

Kjo gjykatë vlerëson se pretendimet ankimore të debitorit nuk qëndrojnë, ashtu që si të tilla i refuzoi si të pabazuara ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërtetoi.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga arsyet e lartcekurat, në pajtim me dispozitën e nenit 208 e lidhur me nenin 209 pika (a) të LPK-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.603/24, me datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi